



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Nr.1, TIRANË

Nr. 1109 Prot

Tiranë më 17.10.2025

Lënda: *Njoftim për lëvizje paralele*

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; Ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Ofruesi publik i QFP Qendra e Formimit Profesional Publik Nr.1, Tiranë,

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin Instruktor i kursit "Parukeri"- 1 Person.

KRITERET E PËRGJITHSHME DHE KRITERET E POSAÇME

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin po aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

II. DOKUMENTET E APLIKIMIT

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin;
- Jetëshkrimin (CV-në);
- Kartën e identitetit;
- Diplomën;
- Librezën e punës;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- -Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorezohen në protokollin e ofruesit publik të QFP-së, brenda datës 27.10 2025.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” i ndryshuar.

